



Turilli!

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 1063 Prot.

Lezhë, më 04 / 06 / 2026

U R D H Ë R

Nr. 415 ., datë 04/06 / 2026

“PËR  
ZBATIMIN E PROJEKTIT “TEMPUS, SPIRITUS I TOKËS (TSITOKES)”

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligji Nr. 45/2024, datë 8.2.2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat”, Marrëveshjen e Konsorcium ndërmjet AURIVE Agjencinë Ekzekutive Europiane të Arsimit dhe Kulturës (Koordinator Projekti) dhe Bashkisë Lezhë (Partnerë Projekti) për projektin “TEMPUS, SPIRITUS I TOKËS (TSITOKES)”, të protokolluar në Bashkinë Lezhë me Nr. 1216 Prot., datë 28.01.2026, VKB-në Nr. 20., datë 25.02.2026 “Për Miratimin e Marrëveshjes së Konsorciumit ndërmjet AURIVE Agjencinë Ekzekutive Europiane të Arsimit dhe Kulturës dhe Bashkisë Lezhë për projektin “TEMPUS, SPIRITUS I TOKËS (TSITOKES)”, si dhe Vendimin Nr. 393., datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”;

U R D H Ë R O J:

1. Krijimin e grupit të punës për zbatimin e projektit “Tempus, Spiritus i Tokës (TSITOKES)”;
- **Brikena Vuksani** – Kryetar i grupit, me detyrë Zv/ Kryetar i Bashkisë Lezhë;
  - **Vasilika Laska** – Koordinator i grupit, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës;

- **Mariolina Lleshi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
  - **Altin Lleshi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike;
  - **Keler Sufja** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore;
  - **Renaldo Xhani**- Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Turizmit
  - **Megi Prela** – Anëtar, me detyrë Përgjegjes Sektori, Drejtoria Projekte Strategjike;
  - **Kiara Alia** – Anëtar, me detyrë Specialist; Drejtoria Projekte Strategjike;
  - **Paulin Zefi** – Anëtar, me detyrë Përgjegjes Sektori, Drejtoria e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore.
2. Koordinator i grupit do të koordinojë punën ndërmjet grupit të punës për zbatimin e aktiviteteve të projektit.
  3. Anëtarët e grupit do të angazhohen në zbatimin e projektit sipas fushave dhe detyrave funksionale që ato kanë.
  4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet grupi i punës.
  5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
Pjerin Ndreu

